



INTERNATIONAL INSTITUTE FOR PRIVATE  
COMMERCIAL AND COMPETITION LAW  
(IIPCCL)

**IIPCCL PUBLISHING**

# **Balkan Journal of Interdisciplinary Research**

## **Education Issues**

ISSN 2410-759X (print)  
ISSN 2411-9725 (online)

**Vol 1, No. 3 - May 2025**

**Graz, Austria 2025**

**Editor in Chief  
Dr. Michaela Wagner**

**Editing  
Dr. Angelika Kogler**

**Scientific Coordinator  
Prof. Dr. Horst-Dieter Westerhoff**

**Editorial Assistant  
Laura Probst**

**Graphic Design  
Dr. Dejan Vujtan**

---

**Copyright © 2015 IIPCCL – International Institute for Private, Commercial and  
Competition Law**

ISSN 2410-759X (print)  
ISSN 2411-9725 (online)

**Vol 1, No. 3 - May 2025**



**This work is licensed under a CC License of  
Attribution-Noncommercial-NoDerivatives 4.0 International (CC BY-NC-ND 4.0).  
Based on a work at iipcl.org.**

**PUBLISHER**

**© IIPCCL- International Institute for Private, Commercial and Competition Law**

**Schönbrunnngasse 12,**

**8043 Graz, Austria**

**Email: [bjir.journal@gmail.com](mailto:bjir.journal@gmail.com), [research@iipcl.org](mailto:research@iipcl.org)**

**Web: <http://www.iipcl.org/>**

**This Journal is printed for IIPCCL**

**by Drimm Publishing House**

**Vienna, Austria**

# **Balkan Journal of Interdisciplinary Research**

## **Education Issues**

**Vol 1, No. 3 - May 2025**

ISSN 2410-759X (print)  
ISSN 2411-9725 (online)

### **About the Journal**

Balkan Journal of Interdisciplinary Research is an international peer-reviewed journal published by International Institute for Private, Commercial and Competition Law. The need for different approaches in science, such as in business, economics, law, social sciences and other fields is a must in the whole field of scientific research. Academics, Professors, Researchers, Students and the whole world is in a new era of communication, which causes fast changes and gives birth to scientific and cultural debates. Our Journal is interested in promoting the exchange of idea, and to bring together researchers and academics from all over the countries. In this sense, we welcome papers not only in the above cited fields, but also in other fields of scientific research. Welcome to BJIR, which is open for the academic world, universities, research institutions, PhD students, academic and non-academic researchers. Aiming at scientific excellence and quality, this journal will promote the best inputs in scientific-and academic research, on the prospective of local, international, global developments in business, economics, law, social-, but also natural sciences. All manuscripts will be double blind peer reviewed by the members of the editorial board who are noted experts in the appropriate subject area.

*Editor in Chief,  
Dr. Michaela Wagner*

# Balkan Journal of Interdisciplinary Research Education Issues

*Editor in chief, Dr. Michaela Wagner*

## International Editorial Board

**Prof. Dr. Jürgen Wolfbauer**  
*Montanuniversitaet Leoben (Austria)*

**Prof. Dr. Ilia Kristo**  
*University of Tirana (Albania)*

**Prof. Dr. Rajmonda Duka**  
*University of Tirana (Albania)*

**Prof. Dr. Azem Hajdari**  
*University of Pristina (Kosovo)*

**Prof. Dr. Horst-Dieter Westerhoff**  
*Universität Duisburg-Essen (Germany)*

**Prof. Dr. Abdylmenaf Bexheti**  
*University of SEEU (Macedonia)*

**Dr. Afërdita Berisha-Shaqiri**  
*University of Pristina (Kosovo)*

**Prof. Dr. Joseph Mifsud**  
*University of East Anglia, London (UK)*

**Dr. Mladen Andrić**  
*Croatian Diplomatic Academy (Croatia)*

**Prof. Dr. Lindita Milo-Lati**  
*University of Tirana (Albania)*

**Prof. Ass. Dr. Naim Baftiu**  
*University of Prizren (Kosovo)*

**Dr. Hans-Achim Roll**  
*Rechtsanwalt (Germany)*

**Prof. Dr. Iraj Hashi**  
*Staffordshire University (UK)*

**Prof. Ass. Dr. Evis Kushi**  
*University of Elbasan (Albania)*

**Prof. Dr. Nabil Ayad**  
*University of East Anglia, London (UK)*

**Prof. Dr. Mimoza Karagozi (Kore)**  
*University of Tirana (Albania)*

**Dr. Eda Bezhani**  
*University of Durres (Albania)*

**Prof. Em. Heinz Dieter Wenzel**  
*University of Bamberg (Germany)*

**Prof. Ass. Dr. Arseno Gjipali**  
*University of Tirana (Albania)*

**PhD (Argosy University) Gerti Dajçi**  
*Tirana Business University (Albania)*

**Prof. Dr. Bektash Mema**  
*University of Gjirokastra (Albania)*

**Dr. Sasha Dukoski**  
*University of Bitola (Macedonia)*

## TABLE OF CONTENTS

<b>Të mësuarit nëpërmjet klasave digjitale .....</b>	<b>6</b>
<i>Lediona Ahmet Selaj</i>	
<b>The development of EU Integration.....</b>	<b>19</b>
<i>Arben Luli</i>	
<b>Economic crisis - Theoretical explanation.....</b>	<b>25</b>
<i>Lorena Grila</i>	

## Të mësuarit nëpërmjet klasave digjitale

Lediona Ahmet Selaj

### Abstrakt

Integrimi i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në arsimin e sotëm ka përparuar me hapa gjigante në mbarë botën duke rritur ndjeshëm cilësinë e tij. *Është* e qartë se në kuadrin e globalizimit, nxënësit tashmë presin që teknologjitë të jenë pjesë e përvojës së të nxënit. Studimet tregojnë se teknologjia mund të përshpejtojë, pasurojë dhe thellojë aftësitë bazë; të motivojë dhe angazhojë të mësuarit e nxënësit; të ndihmojë lidhjen e mësues - nxënës; të forcojë mësimdhënien; të rrisë qëndrueshmërinë e brezave të nesërm; të kontribuojë në ndryshimin e shkollës dhe të lidhë shkollën me botën reale (Watson 2006; Wardle 2008). Sot, shumë forma të informacionit dhe teknologjive të komunikimit mund të jenë mjete mësimore efektive, nëse përdoren me mençuri dhe në mënyrën e duhur. Prandaj, *është* e rëndësishme për mësuesit të kuptojnë rëndësinë e saj dhe t'i aplikojnë këto teknologji në procesin mësimor (mësimdhënie dhe të nxënit). Shoqëria në të cilën jetojmë *është* vazhdimisht në zhvillim. Ndërkohë që ne ecim nëpërmjet epokës së teknologjisë së informacionit, arsimit nuk mund të jetë imun ndaj këtyre ndryshimeve. Një përdorim efektiv i teknologjive në shkolla mund të ketë një impakt imediat pozitiv në mjediset mësimore të shkollave si p.sh. duke krijuar një bashkëveprim dhe komunikim më dinamik midis nxënësve dhe mësuesve, duke rritur bashkëpunimin dhe punën në ekip në veprimtaritë e zgjidhjes së problemeve, duke stimuluar kreativitetin tek nxënësit dhe mësuesit dhe duke ndihmuar nxënësit të kontrollojnë dhe monitorojnë njohuritë e marra. Gjithashtu, situata e masave shtrënguese të aplikuara në të gjithë botën nga pandemia Covid-19 për një periudhë kohore që varioi nga 6 muaj deri në 18 muaj i detyroi njerëzit anëmbanë botës që të përdorin shumë më tepër se më parë teknologjinë për të punuar nga shtëpia, për të mësuar nga shtëpia, për të bërë pazar nga shtëpia etj. Shumë prej tyre, veçanërisht nga vendet në zhvillim e gjetën veten të papërgatitur për këtë situatë dhe bënë sforco të mëdha për t'ia dalë mbanë. Veçanërisht për nxënësit e arsimit 9-vjeçar ka qenë një sfidë më vete duke qenë se gjithçka ndodhi papritmas dhe i gjeti të madh e të vogël pa përgatitur. Nga ana tjetër kjo situatë nxori në pah dukshëm nevojën e përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit jo vetëm në kohë emergjencash. Nëse duam të jemi të përgatitur për *çdo* situatë duhet ta bëjmë TIK pjesë të mësimdhënies dhe komunikimit aktiv dhe gjithëpërfshirës mes aktorëve të arsimit, ashtu siç tashmë ka ndodhur në fushën e qeverisjes qendrore, në sektorin bankar dhe në tregtinë elektronike (online) të cilat në vendin tonë kanë përparuar thuajse njësoj si në vendet e avancuara teknologjike.

### 1. Hyrje

Përdorimi me sukses i teknologjive të aplikuara në shkolla mund të ndihmojë nxënësit të zhvillojnë aftësitë komunikuese; aftësitë specifike për përdorimin e teknologjisë dhe ato njohuri që përgjithësisht, mund të jenë të dobishme për ta në të ardhmen e tyre akademike dhe profesionale. Nxënës të tillë do të kenë avantazhin e të qenit të familjarizuar me mediat e ndryshme, të zakonshme në vendet moderne të punës dhe do të jenë të aftë të përdorin këto aftësi teknologjike për të hyrë në informacion, për të grumbulluar, për të sintetizuar dhe për të këmbyer këtë informacion me efektivitet.

## 2. Qëllimi

- Hartimi i një strategjie efikase për një ndërveprim përmes teknologjisë.
- Kualifikimi i stafit të mësuesve dhe nxënësve për njohjen dhe përdorimin e gjuhës së teknologjisë.
- Koordinimi i një procesi ndërveprues mes shkollës dhe prindërve/komunitetit.
- Aplikimi i një komunikimi në kohë reale për arritjet e nxënësve dhe problematikat që hasen në shkollë

## 3. Hipotezat

- a) Standardizimi i nivelit të përgatitjes së mësuesve lidhur me mësimin dhe komunikimin online përmes platformave bazë
- b) Përmirësimi i komunikimit real dhe në kohë mësues-prindër-nxënës c) Përmirësim i transparencës së vlerësimit dhe situatës reale të shkollës
- d) Përgatitja e stafit mësues dhe e komunitetit për mësimdhënie në situata të emergjencës si tërmeti, pandemi etj, si pikënisje për edukimin e nxënësve me njohuri teorike e praktike të shkollave të shekullit 21.

## 4. Pyetja kerkimore

Përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në procesin e të mësuarit rrit të nxënësve?

Aplikimi dhe zbatimi i teknologjive të reja në shkollë kërkon rritjen e njohurive për këto teknologji edhe nga vetë mësuesit. Mësuesit e shkollës duhet ecin në të njëjtin hapi me teknologjinë në ndryshim, me qëllim që të sigurojnë rolin e tyre të rëndësishëm të komunikimit në transmetimin e njohurive të nxënësve. Për të komunikuar me anën e teknologjive të reja mësimore *është* e domosdoshme aftësimi i mësuesve dhe trajnimi i tyre për përvetësimin e shkathtësive informatike, mediatike dhe teknologjike.

Në mësimdhënie dhe në zbatimin e teknologjive të reja rol luan gjithashtu moshën dhe përvojën e mësuesve. Faktet tregojnë se moshën e mësuesve e lidhur me këtë dhe përvojën e tyre, paraqitet si element i rëndësishëm për zbatimin e teknologjive dhe pranimin e tyre në praktikë, por sipas Vadahi et al. (2013) *është* e qartë se mësuesit me përvojë kërkojnë liri më të madhe dhe anojnë më shumë nga qasjet tradicionale apo modifikimi i tyre në procesin e mësimdhënies. Duke parë historikun e shkollës vëmë re se numri i nxënësve *është* i vogël dhe kjo bën të mundur që të përdoret si shkollë pilot për zbatimin e këtij projekti. Gjithashtu kjo shkollë bën mësim me një turn, gjë që krijon hapësira për shfrytëzimin e kohës pasdite, për aktivitete të tjera që janë të lidhura drejtpërdrejt apo tërthorazi me objektivat e projektit tonë si trajnime, punë në grup, takime online, mësim online etj. Komuniteti *është* arsimdashës dhe bashkëpunues. Veç kësaj, një nga përparësitë e planit afat-mesëm të shkollës "Siri Kodra" *është* rritja e përdorimit të teknologjisë nga mësuesit dhe nxënësit, faktor që e bën projektintonë relevant për suksesin e kësaj shkolle. Një tjetër aspekt, që vihet re nga të dhënat e ofruara nga plani vjetor dhe ai afat-mesëm *është* mungesa e trajnimit

specifik, të përditësuar dhe të standardizuar të stafit (përfshi edhe drejtorinë) lidhur me përdorimin e programeve bazë kompjuterike. Programet dhe teknologjitë e komunikimit janë gjithnjë në ndryshim dhe për këtë duhet që stafi mësimor të marrë trajnime të vazhdueshme periodike të paketave Office dhe pajisjeve/programeve specifike që lidhen me komunikimin interaktiv. Duhet të arrihet ai nivel që mësuesi të jetë gjithnjë një hap përpara, ose në një hap me nxënësit, sa i takon zhvillimit të teknologjisë së informacionit dhe teknologjisë së edukimit në veçanti. Ndërkohë prindërit duhet të përditësojnë njohuritë e tyre bazë për përdorimin e teknologjisë së informacionit për të qënë pjesë e këtij komunikimi modern.

## 5. Metodologjia e kërkimit dhe metodat

Si metodologji për mbledhjen e të dhënave *është* përdorur metoda e mbledhjes së të dhënave sasiore-cilësore përmes statistikave të vetë shkollës si për *çështje* të përgjithshme dhe përmes pyetësorëve specifikë të hartuar enkas për projektin tonë. Gjithashtu për grumbullimin e të dhënave shtesë janë zhvilluar intervista të drejtpërdrejta me aktorë kyç të shkollës si edhe me grupe nxënësish të klasave të arsimit fillor si edhe me prindër që nuk kanë qasje në mjetet e komunikimit elektronik. Veç këtyre *është* përdorur edhe metoda empirike për analizën e situatës bazuar te historiku i shkollës dhe të dhënat sasiore-cilësore që ofrohen nga Plani Afatmesëm dhe Plani Vjetor i Shkollës Një pjesë të rëndësishme për orientimin e projektit kanë luajtur edhe burime të hapura informacioni në internet, të cilat gjenden në uebliografinë në fund të këtij projekti. Nga analiza e përgjigjeve të nxënësve vihet re se tashmë pjesa më e madhe e tyre janë familjarizuar me përdorimin e teknologjisë në terma të përgjithshme, edhe për mësimin online, kjo edhe për faktin se tashmë një pjesë e mirë e tyre kanë pajisje smart personale si edhe faqe Instagrami apo Facebook, etj. Sidoqoftë, forma e mbledhjes së të dhënave të mësipërme ka qënë ajo me platformën Google Forms dhe për rrjedhojë të anketuarit ipërkasin klasave të VIII dhe IX dhe kjo mund të jetë arsyeja që kemi këtë raport përgjigjesh. Ne zhvilluam edhe rreth 20 intervista me gojë me fokusgrupe me nga 7 fëmijë me nxënës të arsimit fillor të zgjedhur në mënyrë rastësore, të cilët në përgjigjet e tyre reflektuan vështirësi të shumta lidhur me përdorimin e teknologjisë mes të cilave ishte edhe mungesa e një kompjuteri apo celulari që mund të përdoret për këtë qëllim. Nëse do merreshin parasysh edhe grupet sociale të marginalizuara kjo do çonte në ndryshim të raporteve të përgjigjeve, duke nxjerrë në pah nevojën e një qasjeje më gjithëpërfshirëse dhe më të plotë për trajnim, lidhur me përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie e mësimnxënie. Gjithashtu, ky propozim nuk na mundëson hapësirën kohore të nevojshme për mbledhjen e të dhënave të mjaftueshme dhe hartimin e pyetjeve specifike lidhur me njohuritë e nxënësve për përdorimin e teknologjisë në mësimnxënie. Kjo mbetet për tu bërë në një kohë më të përshtatshme dhe me përfshirjen edhe të aktorëve të tjerë më të specializuar si mësuesit apo specialistë të TIK, sociologë, analistë të dhënash etj. Nga të dhënat e mbledhura prej pyetësorëve me mësuesit vihet re se pjesa më e madhe e tyre e përdorin teknologjinë e informacionit në përditshmërinë e tyre, por këto të dhëna nuk na tregojnë se sie përdorin (shumë mirë, mirë apo keq) dhe në çfarë mase.

Gjithashtu, në të dhënat mbi trajnimet që mësuesit kanë marrë vihet re se vetëm 50 % kanë një trajnim mbi njohjen e kompetencave digjitale, por nuk rezulton asnjë mësues që të jetë trajnuar mbi komunikimin online dhe përdorimin e platformave serioze të komunikimit dhe mësimdhënies online si ZOOM, Google Classroom apo Akademi.al. Kjo lë të nënkuptohet se ata kanë mësuar gjatë përdorimit të këtyre programeve dhe për shkak të nevojës së situatës së krijuar nga pandemia e Covid-19. Për rrjedhojë kjo e kufizon së tepërmi aftësinë dhe shfrytëzimin e plotë të programeve të tilla si MS Word, MS Excel, PowerPoint etj., të cilat janë bazike dhe të domosdoshme për përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi të tyre si mësimdhënës.

## 6. Mundësitë dhe kufizimet

Aplikimi dhe zbatimi i teknologjive të reja në shkollë kërkon rritjen e njohurive për këto teknologji edhe nga vetë mësuesit. Mësuesit e shkollës duhet ecin në të njëjtin hapi me teknologjinë në ndryshim, me qëllim që të sigurojnë rolin e tyre të rëndësishëm të komunikimit në transmetimin e njohurive të nxënësit. Për të komunikuar me anën e teknologjive të reja mësimore *është* e domosdoshme aftësimi i mësuesve dhe trajnimi i tyre për përvetësimin e shkathtësive informatike, mediatike dhe teknologjike. Në mësimdhënie dhe në zbatimin e teknologjive të reja rol luan gjithashtu moshja dhe përvoja e mësuesve. Faktet tregojnë se moshja e mësuesve e lidhur me këtë dhe përvoja e tyre, paraqitet si element i rëndësishëm për zbatimin e teknologjive dhe pranimin e tyre në praktikë, por sipas Vadahi et al. (2013) *është* e qartë se mësuesit me përvojë kërkojnë liri më të madhe dhe anojnë më shumë nga qasjet tradicionale apo modifikimi i tyre në procesin e mësimdhënies. Një tjetër aspekt, që vihet re nga të dhënat e ofruara nga plani vjetor dhe ai afat-mesëm *është* mungesa e trajnimit specifik, të përditësuar dhe të standardizuar të stafit (përfshi edhe drejtorinë) lidhur me përdorimin e programeve bazë kompjuterike. Programet dhe teknologjitë e komunikimit janë gjithnjë në ndryshim dhe për këtë duhet që stafi mësimor të marrë trajnime të vazhdueshme periodike të paketave Office dhe pajisjeve/programeve specifike që lidhen me komunikimin interaktiv. Duhet të arrihet ai nivel që mësuesi të jetë gjithnjë një hap përpara, ose në një hap me nxënësit, sa i takon zhvillimit të teknologjisë së informacionit dhe teknologjisë së edukimit në veçanti. Ndërkohë prindërit duhet të përditësojnë njohuritë e tyre bazë për përdorimin e teknologjisë së informacionit për të qënë pjesë e këtij komunikimi modern.

Duke parë historikun e shkollës vëmë re se numri i nxënësve *është* i vogël dhe kjo bën të mundur që të përdoret si shkollë pilot për zbatimin e këtij projekti. Gjithashtu kjo shkollë bën mësim me një turn, gjë që krijon hapësira për shfrytëzimin e kohës pasdite, për aktivitete të tjera që janë të lidhura drejtpërdrejt apo tërthorazi me objektivat e projektit tonë si trajnime, punë në grup, takime online, mësim online etj. Komuniteti *është* arsimdashës dhe bashkëpunues.

Me zhvillimin e teknologjisë elektronike dhe asaj të informacionit, mësimi në distancë u prit me interes nga nxënës me aftësi të kufizuara, nga ata në pamundësi ekonomike për të ndjekur universitetin në mënyrë tradicionale, drejtues të bizneseve të vogla, individë me nevoja për trajnime dhe kurse specifike dhe individë të caktuar me kohë

të kufizuar për shkak të angazhimeve dhe impenjimeve në punë, ose veprimtarive të tjera jetësore.

Për target grupet e mësipërme mësimi në distancë u pa si avantazh, që u jepte mundësinë atyre të pajiseshin me njohuritë e duhura dhe certifikoheshin sipas zgjedhjeve të tyre. Në Shqipëri kjo metodë u testua nga disa universitete private, por nuk ishte aplikuar në institucionet arsimore publike.

Nisur nga rrethanat që u krijuan nga pandemia botërore COVID-19, u pa e nevojshme që mësimi në distancë të aplikohet në të gjitha institucionet arsimore publike dhe private. Implementimi i kësaj praktike të re në fushën e mësimdhënies i gjeti shumicën e institucioneve arsimore të papërgatitura. Krahas vështirësive fillestare që u hasën nga personeli arsimor dhe nxënësit, mësimi në distancë po nxjerr në pah disa dilema që shtrojnë një sërë pyetjesh për përmirësimin e kësaj platforme. Cilat janë këto dilema dhe si duhet të trajtohen ato nga institucionet arsimore, drejtuesit dhe stafet mësimore të tyre?

## 7. Rëndësia e studimit

Prindërit kanë vështirësidhe nuk arrijnë të kenë qasjen që nevojitet në teknologjinë e komunikimit dhe informacionit.

Pozitiv *është* fakti se prindërit kanë komunikim online me mësuesit në lidhje me problematika apo vështirësi të fëmijëve në shkollë dhe gjithashtu duket se kanë qasje në platformat elektronike, por mbetet e paqartë se në *çfarë* niveli i përdorin ato dhe nëse ka hendek të nivelit të përdorimit mes prindërve.

Bashkëveprimi i tre aktorëve të rëndësishëm mësues – nxënës – prindër në funksionin e formave të reja të mësimdhënies – mësimnxënies.

Ky bashkëveprim ka qenë kryesisht fizik, i fokusuar në takime të mirëprogramuara sipas një plani veprimtarish, nga mësuesit kujdestar dhe drejtorja e shkollës. *Çdo* tematikë trajtohej në këto takime dhe diskutohej e merreshin vendime, bëheshin analiza dhe arriheshin konkluzione direkte. Pandemia e shkaktuar nga COVID-19 ndryshoi shumë gjëra: mësimi u organizua me turne, klasat u ndanë në dy grupe duke respektuar rregulloren.

Kjo e bëri të vështirë komunikimin, si mes kolegësh, por edhe mes mësuesve e nxënësve, nxënësve me njëri-tjetrin; për më tepër komunikimin me prindërit. *Çdo* gjë kaloi në komunikim online, ose e reduktuar, duke futur në lojë teknologjinë. Pjesa më e madhe e mësuesve (u përshtatën shpejt), por veçanërisht prindërit dhe nxënësit u gjendën të papërgatitur përballë një situatë të tillë. Nëse sot u përballëm dhe po e kalojmë këtë vështirësi, nuk na falet nëse në një situatë të ngjashme të vazhdojmë të jemi të papërgatitur.

### 1 - Bashkëpunimi shkollë – familje

Shkolla dhe familja përbëjnë dy faktorë të rëndësishëm të edukimit dhe arsimit tek brezat e rinj. “Rëndësia e bashkëpunimit shkollë-familje *është* se përmes tij arrihet njohja më e plotë dhe më e thellë i personalitetit të nxënësit” (Zuna, 2009). Rruga se si krijohet ky komunikim ndërmjet shkollës dhe familjes realizohet në disa mënyra,

duke përfshirë: kontaktet individuale, takimet me prindër, ligjërata pedagogjike, shfaqje, ekspozita, seminare dhe, së fundi, si teknikë më e re janë kontaktet online, ose duke shfrytëzuar teknologjitë e reja. Kjo nënkupton përdorimin e kompjuterëve dhe softuerw-ve, në mënyrë produktive, shfrytëzimin e Internetit për qëllime produktive. "Komunikimi, *është* ndoshta pjesa më e rëndësishme e shkollës, sepse nëse të gjitha grupet janë të informuara mirë dhe dinë si të komunikojnë me njëri-tjetrin, ata janë të gjithë më të motivuar për të zhvilluar cilësinë e shkollës dhe për të punuar së bashku në mënyrë intensive në fusha të ndryshme" (Mattheis & Wildbad & Mehmeti, 2012).

Bashkëpunimi shkollë-familje përmirëson programet shkollore dhe klimën në shkollë, ofron shërbime dhe mbështetje për familjet, rrit aftësitë e prindërve dhe rolin drejtues të tyre, krijon lidhje midis prindërve në shkollë dhe ndihmon mësuesit në punën e tyre. Mbi të gjitha, partneritete të tilla krijohen për të ndihmuar që nxënësit të kenë sukses në shkollë dhe në jetë.

### *.2. Rëndësia e bashkëpunimit për shkollën*

Një shkollë *është* një institucion i projektuar për mësimin e nxënësve nën drejtimin e mësuesve. Rëndësia e bashkëpunimit shkollë-familje *është* se arrijnë të njihen më mirë si dhe të kuptojnë, të mbështesin dhe të përmirësojnë pozicionin dhe funksionet e shkollës .

Praktikat e kujdestarëve të klasës në lidhje me përfshirjen e prindërve kanë efekte mjaft pozitive në aftësitë e prindërve për t'i ndihmuar fëmijët e tyre përgjatë viteve të shkollës; në vlerësimin e prindërve për aftësitë e mësuesve dhe cilësinë e mësimdhënies.

Vendosja e raporteve pozitive midis dy partnerëve në shkollë, kërkon komunikim dhe bashkëpunim të të gjithë faktorëve të shkollës dhe ky komunikim dhe bashkëpunim duhet të jetë në interes dhe në funksion të shkollës cilësore të shekullit të 21-të.

### *.3. Rëndësia e bashkëpunimit për familjen*

Përfshirja e familjeve në punën e shkollës *është* njëri prej elementeve kryesore për të arritur rezultate më të mira të nxënësve. Studimet shkencore gjatë tridekadave të fundit kanë vërtetuar se përfshirja e prindërve *është* mjaft e rëndësishme në procesin e të nxënësve të fëmijëve, në mendimin e tyre për shkollën dhe në aspiratat e tyre. Fëmijët janë nxënës më të suksesshëm përgjatë gjithë shkollës nëse prindërit e tyre përfshihen në shkollë dhe inkurajojnë të mësuarit në shtëpi, pavarësisht nga niveli arsimor apo shoqëror i tyre. Rëndësia e bashkëpunimit për familjen *është* se përmes saj arrijnë të njohë fëmijën, të hulumtojnë dhe të kuptojnë shkaqet e vështirësive në nxënie. Reflekton në qasjen përkatëse edukative, i mbështet sjelljet e mira dhe aspiratat e drejta të fëmijës; e përmirëson funksionin edukativ dhe arrin edukim më cilësor, arrin të përjetojë ndjenjën e triumfit edukativ, i cili ndikon në mënyrë kualitative në sukses; nxit angazhimin për arritjen e suksesit tjetër.

Përfshirja e prindërve në shkollë, *është* më shumë se vetëm pjesëmarrja në takime kur ftohen, apo edhe në situata kur ka vështirësi dhe probleme me fëmijët. Përfshirja e prindërve do të thotë pjesëmarrje e prindërve në bashkëpunim në mënyrë direkte

(ballë për ballë), apo edhe përmes botës virtuale apo TIK-ut, duke shfrytëzuar telefonat dhe kompjuterët.

#### *.4. Rëndësia e bashkëpunimit për nxënësin*

Rëndësia e bashkëpunimit shkollë-familje, ku si objekt kryesor i këtij komunikimi *është* nxënësi. Për nxënësin *është* shumë i rëndësishëm ky bashkëpunim, sepse arrihet njohja dhe të kuptuarit më i plotë dhe më i thellë i personalitetit të nxënësit si për shembull: veçoritë e karakterit; tiparet e vullnetit; qëndrimet në lidhje me vetveten dhe familjen; sfera afektive të personalitetit, sjelljet e përshtatshme dhe të papërshtatshme, deri tek ato devijante; mënyra e të nxënit, ecuria e metodave, etj.

#### *.5. Përfitimet e bashkëpunimit shkollë-familje*

Shkolla do të jetë e hapur ndaj mjedisit, ta bëjë publike punën e vet, gjithëpërfshirëse. Mbyllja e shkollës ndaj komunitetit zvogëlon në masë të madhe efikasitetin dhe përfitimet sitë nxënësit, objekt i këtij hulumtimi, po ashtu edhe të kolektivit të shkollës në përgjithësi.

Përfitimet e bashkëpunimit shkollë-familje janë të dyanshme, sepse në këtë rast rritet efikasiteti i shkollës, rritet cilësia në mësimdhënie. Familja dhe kujdestari do të ndikojnë në suksesin ose vështirësinë e nxënësit; d.m.th të dyja palët vendosin qëllime të qëndrueshme dhe komunikojnë më vete gjatë gjithë kohës. Rritja e përfshirjes së prindërve në zgjidhjen e problemeve që ekzistojnë në shkollë do të ndikojë drejtpërdrejt në proceset e demokratizimit dhe decentralizimit në shkollë. Përfshirja e prindërve në procesin e mësimdhënies/nxënies do të ndikojë pozitivisht në arritjet akademike të *çdo* fëmije dhe në përmirësimin e sjelljes së tij/saj. Komunikimi përmes teknologjisë e lehtëson shumë këtë bashkëpunim mes shkollës dhe komunitetit.

#### *.6. Bashkëpunimi shkollë-familje duke shfrytëzuar TIK-un*

Përmes TIK-ut informacionet e shkëmbyera janë më të pasura; shoqëria e bazuar në dije nevojitet që të zotërojë aftësi të mira komunikuese dhe sociale, të jetë e mirëinformuar dhe të jetë gjithmonë e gatshme për marrjen dhe dhënien e informacionit të nevojshëm. Aktorët gjithashtu duhet që të komunikojnë mes tyre në mënyrë kreative duke gjetur zgjidhje origjinale për problemet. Në kohën tonë ndikimi i Teknologjisë Informative dhe Komunikimit (TIK) gjithnjë e më shumë bëhet gjithëpërfshirës në shumë sfera shoqërore. Informacionet që shkëmbehen apo shfaqen përmes TIK-ut janë mjaft të pasura, sepse *është* rrjeti (Interneti) i cili ju mundëson individëve qasje në kohë reale. Nga hulumtimi që kemi realizuar vihet re se shumica e prindërve kanë përmendur edhe mënyrën më të pëlqyer të komunikimit, që ishte aplikacioni WhatsApp. Vlen të theksohet se sot, përmes rrjeteve sociale (Facebook) apo edhe përmes WhatsApp-it, secili prind mund t'i bashkohet grupit të komunikimit, ku bën pjesë fëmija i tij dhe të shohë të gjitha aktivitetet të cilat klasa i realizon apo udhëzimet, që jepen nga mësuesit.

Përmes TIK-ut kursehet kohë gjatë bashkëpunimit shkollë-familje; që të ketë kohë për gjërat e rëndësishme, duhet ditur se cilat janë ato. Kjo bëhet më e lehtë nëse e ke të qartë *çfarë* ka vlerë për ty, *çfarë* synimesh ke. Të qëndruarit në komunikim online në kohën e sotme *është* bërë mjaft e domosdoshme, thuajse pjesa kryesore e

aktivitetit ditor. Të kesh një celular do të thotë të komunikosh, të dërgosh mesazhe, të argëtohesh, të informohesh, të memorizosh momentet e bukura gjatë ditës, të mbash shënime, të bësh llogari e shumë e shumë gjëra të tjera. Përmes TIK-ut komunikimi në distancë *është* më i lehtë. Në ditët e sotme celulari *është* një nga objektet më të domosdoshme të jetës së përditshme. Për shumicën prej nesh, jeta *është* e vështirë të mendohet pa një të tillë. Tashmë, jo vetëm për komunikim por dhe për prezantimin e aktivitetit të përditshme në botën virtuale.

Teknologjia e informacionit dhe komunikimit ose (TIK)

Mënyra të ndryshme TIK-u

- Telefoni: shërbendhe ndihmon në komunikim sipërmes akustikës (zërit), po ashtu edhe përmes shkrimit të mesazheve dhe pamjeve vizuale. Ato njihen me emrin Smartphone (telefonat e mençur).
- Përveç veçorive të lartpërmendura, përmes Smartphone-ve mund të ketë qasje edhe në programe të tjera siç janë: Facebook, Viber, E-Mail etj. Kur flitet për bashkëpunimin shkollë-familje, telefoni *është* pajisja, e cila shfrytëzohet shumë dhe me përfitime shumë të mëdha përdorimi.
- Viber - Viber *është* një ndër platformat e mesazheve të shpejta, që shfrytëzon internetin (Wi-Fi). Viberi zakonisht instalohet si program në smartphone me kartë identifikimi të numrit personal. Përveç mesazheve tekst, përdoruesit mund të shkëmbejnë imazhe, video dhe mesazhe audio.
- Në Viber ekziston mundësia e krijimit të grupit të përbashkët, të cilin mund ta krijojë *çdo* person me persona që kanë interesa të përbashkëta. Në aspektin e bashkëpunimit shkollë-familje, Viberi e lehtëson punën e përdoruesve, sepse posedon veçoritë të përmendura më lart.
- E-Mail - Posta elektronike - Me ndihmën e kësaj poste bëhet shpërndarja e letrave elektronike nga dërguesi tek marrësi. Me përhapjen e këtij shërbimi në internet gjithnjë e më tepër njerëzit, e sidomos ekonomistët, përdorin këtë formë të këmbimit të letrave në vend të formave klasike.
- E-Mail ka këto veçori: posta elektronike dërgon letrën brenda disa sekondash, pa marrë parasysh distancën. Dërgimi i letrave me postë elektronike kushton shumë pak, në krahasim me postën klasike.
- Skype - (lexo: Skajp) *është* një server falas, i cili në vetvete ka komunikimin e *çastit*, dërgimin e anasjelltë dhe të drejtpërdrejtë të të dhënave nga njëri përdorues tek tjetri me mundësi video-komunikimi. Në raportin e bashkëpunimit shkollë – familje shfrytëzohet shumë; thuhet se zëvendëson takimin ballë për ballë.
- Google Classroom *është* një platformë dinamike interaktive e paketës Google. Përdoret lehtësisht në fushën e edukimit dhe nga institucionet arsimore. Me anë të kësaj platforme orientohet klasa dhe mësimi online, të cilat arrijnë ta përthithin me sukses përpunimin, shpërndarjen dhe asimilimin e informacionit shkencor. *Është* një platformë e cila lehtëson mësimdhënien duke e bërë orën e mësimi interaktive.
- Zoom: *Është* një platformë që i dedikohet video-konferencave, apo takimeve virtuale, duke ndihmuar miliona njerëz në studimet e tyre. *Është* një platformë praktike e cila realizon mësimin online në mënyrë efektive.
- Academi.al *është* një platformë komunikimi virtuale me anë të videove mësimore sipas lëndëve dhe klasave për mësimin online. Komunikimi *është* i drejtpërdrejtë

dhe i monitorueshem në aspektin e mësimdhënies dhe nivelit të arritjeve të nxënësve.

- Si zhvillohet mësimi me anë të teknologjisë;3
- Mësimi i cili ka në fokus teknologjinë nuk do të kishte kuptim nëse:
- § Nuk do t'i kushtonte një rëndësi të madhe njohurive shkencore dhe akademike. Për këtë arsye teknologjia furnizon nxënësin me një fjalor të gjerë shkencor dhe akademik.
- § Ndërveprimet mes nxënësve me njëri-tjetrin, mësuesve dhe vetes nuk do të siguronin arritje më të mira. Pra, mësuesi përzgjedh veprimtari, metodologji me në fokus përmbushjen e rezultateve të të nxënit.
- § Do mungonte matja dhe vlerësimi i rezultateve të të nxënit nga nxënësi.
- Natyrshëm lind pyetja: Si do të planifikohet mësimi online?
- Mësuesit përcaktojnë
- Metododat dhe metodologjinë më efikase për zhvillimin e mësimin online
- Rezultatet e të nxënit që duhet të arrijnë gjatë orës së mësimin
- Aktivitete dhe teknika për t'u zhvilluar gjatë një ore mësimi dhe kohën që merr *çdo* aktivitet për t'u zhvilluar.
- ormat e vlerësimit sipas niveleve të nxënësve

Ndërveprimi për procesin e të nxënit përfshin:

- Prezantimin ose referate për tema të caktuara
- Materiale të cilat nxisin mendimin vizual
- Faqe interneti të zhvilluara nga mësuesi dhe të rekomanduara si burime të sakta informacioni

### Objektivat operacionale

Trajnimin e mësuesve, prindërve dhe nxënësve për komunikimin me anë të teknologjisë

- Përfshirja në trajnime të brendshme, në lidhje me teknologjinë
- Pajisja e institucionit me mjetet e duhura si kompjuterë, laptopë funksionalë, smart bord, internet etj
- Përshtatja e një mjedisi të duhur fizik për komunikim online

### b) Ndarja e detyrave për hartimin e punës

*Si do të udhëhiqet procesi?*

- Njohje me Udhëzimet përkatëse në lidhje me fillimin e komunikimit online
- Çfarë platformash do të përdoren dhe si

Nr	Grupi i punës	Përbërja
1	Grupi organizues	Stafi drejtues dhe udhëheqësi i projektit Drejtues, kryetar
2	Menaxhimi i punës	të ekipit lëndor dhe ai i këshillit të prindërve, qeveria e nxënësve dhe nxënës me aftësi në TIK/ Kryetarët e ekipeve lëndore dhe mësues
3	Grupi i monitorimit	Nëndrejtor dhe mësues TIK
4	Analiza dhe përpunimi i të dhënave	

- Trajnimi në mënyrë të detajuar për përdorimin e tyre sipas fokus grupeve: trajnime vetëm për mësues, vetëm për nxënës, vetëm për prindër.
- Plani i punës që do të zbatohet drejtoria

### **Hapat e planit të veprimit**

#### **Si do të komunikojnë me njëri-tjetrin mësuesit me nxënësit dhe prindërit?**

- a. Përzgjedhja e 2 platformave për zhvillimin e mësimit online.
- b. Krijimi i grupeve të kontaktit (n/drejtorët) dhe marrja e feed-back gjatë procesit.
- c. Ngritja e një grup pune me mësues të TIK dhe përfaqësues të Qeverisë së nxënësve, ose nxënës me aftësi shumë të mira në përdorimin e teknologjisë, i cili do të merret me digjitalizimin në kohë reale të komunikimit virtual

Hapat për mënyrën e komunikimit online gjatë mësimit:

- Krijimi i regjistrit elektronik për secilin mësues në bazë të klasave dhe lëndëve, në mënyrë që edhe prindërit të kenë akses online përmes platformës të zgjedhur për komunikim.
- Përcaktimi i mënyrave të mësimit, Power-Point, video-tutoriale, Word, academi.al, Google Classroom etj.
- Komunikim me anë të postës elektronike për problematika të ndryshme të nxënies
- Hartimi i një Orarimësimor për mësimit online, duke respektuar kohëzgjatjen, alternimin e lëndëve, shkëmbimin e detyrave, informimin për vlerësimin, raportimi tek n/drejtorët dhe monitorimi se si po ecën procesi.

Si do vlerësojmë arritjet

Teknologjia e ndihmon mësuesin të vlerësojë se sa janë arritur rezultatet e të nxënësve të përcaktuara për atë orë mësimore nëpërmjet vlerësimit të performancës së nxënësve. Vlerësimi mund të jetë përmbljedhës (përmbljedh atë që nxënësit kanë mësuar në fund të një ore mësimi), formues (ndodh gjatë gjithë kohës) ose diagnostikues (i paraprin një mësimi si një mënyrë për të matur atë që nxënësi paraprakisht di). Për këtë do të përdorim metodat e teknologjisë që mbështesin procesin e vlerësimit të nxënësve të cilat janë:

- o Teste elektronike dhe kuiz-e sipas platformave të ndryshme. o Diskutime dhe shkëmbime idesh me fokus grupe të veçanta. o Portofoli digjital.
- o Regjistri për vlerësimin online.
- o Pyetësorë, anketime online për të monitoruar ecurinë dhe për të matur nivelin e kënaqësisë.

Qëllimi kryesor *është* për të pasur në shkollë ekupe lëndore efektive. Prandaj në shtator 2019, u ngritën grupe lëndore të ndarë sipas fushave dhe me drejtues efektivë, të cilët u zgjodhën nga vetë mësuesit për aftësitë e tyre profesionale, pedagogjike, organizative, për etikë në komunikim dhe bashkëpunim, dhe u hartuan plane të zhvillimit profesional (ZHP) bazuar në nevojat.

Megjithatë tërmeti i 26 nëntorit 2019, dhe më pas pandemia e virusit COVID-19, diktuan që zhvillimiprofesionaltë fokusoheshin drejtimit të përballimit të situatave të jashtëzakonshme. Në rastin e tërmetit, falë bashkëpunimit mes Fakultetit të Shkencave Sociale, Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) dhe Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë (MASR):

Ekipet lëndore bënë ndryshime në planet e tyre të ZHP, ku u përfshinë edhe ndërtimi

i planeve dhe trajnimi i mësuesve dhe nxënësve në rast të fatkeqësive natyrore si tërmeti, zjarri, etj. Mësuesve të trajnuar iu ngarkua detyra e trajnerit për kolegët e tyre. Në planet e ekipeve lëndorë u planifikuan trajnime, të cilat do të bëheshin nga psikologjia e shkollës. Gjithashtu, u orientuan mësuesit që në trajnimet e tyre personale të kishin në vëmendje situata të tilla.

Ndërsa shfaqja e pandemisë evidentoi një problem tjetër, nevojën e trajnimit të mësuesve për realizimin e mësimit në distance (online). Referuar tabelës 1, mbi përvojën dhe zhvillimin profesional, në dy vitet e fundit evidentohet se:

1. 90% e mësuesve të shkollës përdorin kompjuterin.

2. Nuk janë bërë trajnime lidhur me mësimin online dhe platformat në funksion të tij. Por mësimi online u bë domosdoshmëri e realitetit të ri pandemik Covid-19.

Më 10 mars 2020, u krijuan klasat në Google Classroom. Mësuesve iu përcollën në WhatsApp hapat e hyrjes dhe kodet përkatëse të klasave. Paralelisht u përdorën edhe WhatsApp-i dhe Zoom-i. Ndërkohë, MASR, ZVAT më 10 mars 2020, i përcollën shkollës "Udhëzues për mësimin në kushtet e shtëpisë, për shkak të situatës së krijuar nga përhapja e virusit Covid-19". Po ashtu që nga ajo ditë e në vazhdim, MASR, ZVAT, iu erdhën në ndihmë shkollave, mësuesve me transmetimin në Radio Televizionin Shqiptar RTSh 1, të orëve mësimore (matematikë, kimi etj.).

Gjithashtu MASR, ZVA i përcollën shkollës materiale të tilla – "Si të përgatishim material në PowerPoint", "Sitë punonim në ZOOM", "Sitë kthenim prezantimin e PowerPoint-it në video" etj.

Ndërkohë, shkolla bashkëpunoi me shtëpitë botuese si Filara Botime, qendrat e trajnimit të lincsuara TeachPeach, Shkolla e Drejtoreve, të cilat i mundësuan stafit tekstet e-book dhe trajnime online mbi mësimin në distance (të gjitha pa pagesë). U regjistruam në trajnime online; tregues janë certifikatat e fituara si më poshtë:

Planifikimi i kurrikulës. 5

Kurrikula me bazë kompetencat dhe risitë e saj. Cikli i familjes dhe adresimi i rasteve të dhunës. Kodi i etikës. Shkolla si qendër komunitare, rëndësia e saj. Komunikimi me nxënësit, zhvillimi moshor. Teknika për të rritur prirjet akademike në klasën tuaj. Të ndizni fitilin e motivimit tek nxënësit e pamotivuar. Ndihma psikologjike pas tërmetit.

Menaxhimi i traumës për nxënësit dhe mësuesit. *Çfarë është* bullizmi dhe format e tij. U punua Udhëzuesi Ndërhyrja e Parë Psikologjike në Kontekstin Shkollor (manual i hartuar nga Departamenti i Psikologjisë dhe Pedagogjisë, Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës si përgjigje ndaj situatës së krijuar nga tërmeti i 26 nëntorit 2019. Grupi i punës: Livia Nano, Valbona Habili, Eglantina Dervishi, Blerta Bodinaku. Të gjitha këto dëshmojmë se MARS, ZVA dhe shkolla, në formë kaskade, kanë mundësuar zhvillimin profesional të mësuesve. Certifikatat janë pjesë e rëndësishme dhe tregues i zhvillimit profesional në këtë kohë, por jo i vetmi.

Të gjithë po mësonin duke vepruar. Ndërkohë, stafi vetë-trajnohej (me informacione nga interneti apo me trajnim individual në qendra të licencuara). Dëshmi janë materialet e përgatitura në PowerPoint si dhe videot e realizuara nga vete mësuesit (një eksperiencë e re kjo e ushtruar më parë) që në ditët e para të mësimit online. Mësimi online ishte eksperiencë e re dhe diktoi bashkëpunim dhe shkëmbim informacioni dhe mënyrën se si zhvillonin mësimin. Nga ana tjetër operimi i të gjithë

